



Pranuar / Dorezuar Pamirëna/Prudato Received/Delivered	08-12-2022	2	vite god Year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicitina Quantity
SKIMSHUK	7787/2022		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.979/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.979/2022 të datës 08.11.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë banimi \_\_\_\_\_ kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1, nenin 16 paragrafi 3 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.979/2022 e datës 08.11.2022 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

A r s y e t i m

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komuna e Prishtinës, më datë 28.10.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të konkursit me Nr. Reference:RN00010301 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit Ligjor", ku afati për aplikim rrjedh nga data 12.11.2022-19.11.2022.

Ankuesi më datë 08.11.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:6777/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore që ky konkurs është shpall me shkelje ligjore dhe duhet të anulohet.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 14.11.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje ne ankesë në Komunën e Prishtinës. Ndërsa Këshilli më datë 29.11.2022

ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me numër protokoll 7462/2022 me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e trajtimit të ankesës ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit me Nr.Prot: 6777/2022 të datës 08.11.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit i datës 28.10.2022 për pozitën Udhëheqës i Sektorit Ligjor; Njoftim i datës 22.08.2022 përmes E-mailit; E-mail zyrtar i datës 17.08.2022; E-mail zyrtar i datës 16.08.2022; E-mail zyrtar i datës 08.08.2022; E-mail zyrtar i datës 02.06.2022; E-mail zyrtar i datës 20.05.2022; Vendimi me nr.14-020-01-10888671/22 i datës 17.05.2022 për zbatimin e vendimit A.nr.316/2022 me numër protokoll 2722/2022 të KPMSHCK-së; Akt emërimi i datës 01.06.2022; Kërkesa për Përgjigje në ankesë e datës 14.11.2022 me numër protokoll 7073/2022; Përgjigje në ankesë e datës 29.11.2022 nga organi i punësimit me numër protokoll 7462/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Vendimi A.nr.316/2022 i datës 11.05.2022 me numër protokoll 2722/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi A.nr.550/2022 i datës 03.08.2022 me numër protokoll 4510/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 02.12.2022; E-mail zyrtar i datës 01.12.2022 dhe E-mail zyrtar i datës 24.11.2022.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, konstatoi, se ankesa e ankuesit është e pajtuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit i cili pretendon që të anulohet konkursi i shpallur për pozitën Udhëheqës i Sektorit Ligjor në Komunën e Prishtinës sipas njoftimit të datës 28.10.2022 ndërsa data e aplikimit ka qenë prej 12.11.2022 deri 19.11.2022, sepse sipas pretendimit të ankuesit Komuna e ka për obligim të vendosë në këtë pozitë ankuesin e jo me shpall konkurs të ri bazuar në nenin 58 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-149 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se *"1.Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës ose në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori"*. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ky pretendim ankimor i ankuesit është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm sepse kjo çështje është vendosur me Vendimin A.nr.316/2022 i datës 10.05.2022 me numër protokoll 2722/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyr për Shërbimin Civil të Kosovës, po ashtu edhe zyrtarja e personelit përmes E-mailit zyrtar të datës 01.12.2022 ka njoftuar/konfirmuar se pozita e F. D i cili ka qenë Udhëheqës i Sektorit Ligjor ka qenë e zënë deri më datën 30.09.2022 ndërsa i njëjti përmes procedurave të lëvizjes paralele ka kaluar në pozitë të Udhëheqësit të Sektorit të Legalizimeve ndërsa i njëjti aktemrimin për këtë pozitë të re e ka nga data 01/10/2022, nga ajo që u konstatue më lartë vërtetohet fakti se në kohën kur është zbatue vendimi i këshillit A.nr.316/2022 i datës 10.05.2022 pozita e Udhëheqësit të Sektorit Ligjor në Komunën e Prishtinës ka qenë e zanun andaj edhe ka qenë e pamundur që i njëjti pas periudhës së pezullimit të kthehet në pozitë të njëjtë që ka qenë më herët përkatësisht para periudhës së pezullimit të dakorduar nga Shërbimi Civil, andaj pretendimi në këtë kuptim është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi nuk ka dërguar asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetonte faktin që i njëjti ka aplikuar në konkursin me Nr. Reference RN00010301 i datës 28.10.2022 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Udhëheqës i Sektorit Ligjor në Komunën e Prishtinës, ndërsa me datën 02.12.2022 zyrtarja e personelit përmes E-mailit

zyrtar ka njoftuar se ankuesi, [REDACTED] nuk ka aplikuar për pozitën Udhëheqës i Sektorit Ligjor në Komunën e Prishtinës .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me këtë çështje juridike-administrative ju referuar Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 125 paragrafi 1, i cili përcakton se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative"), rrjedhimisht ankuesi ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka parashtruar ankesë kundër një akti administrativ apo ndonjë mosveprimi të institucionit, për shkak që nuk ka parashtruar asnjë kërkesë që institucioni ka qenë i obliguar t'i përgjigjet, për me tepër me qenë se ankuesi nuk ka dëshmuar me asnjë provë që ka aplikuar në konkursin me Nr. Reference RN00010301 i datës 28.10.2022 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Udhëheqës i Sektorit Ligjor në Komunën e Prishtinës, atëherë sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, të njëjtit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës apo të njëjti nuk i është mohuar asnjë e drejtë në këtë procedurë, rrjedhimisht pala ankuese nuk ka legjitimitet për parashtrimin e ankesës dhe për pretendimet kundër një procedure që nuk ka qenë pjesë e saj siç parashihet me nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..."* si dhe ndërlidhur me nenin 14 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të këtij ligji.*

Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.979/2022, datë 08/12/2022

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

*Arben Mehmeti*  
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Prishtinës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

